



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

NJOFTIM
PËR KOHËN DHE VENDIN E MBAJTJES SË PROVIM TË JURISPRUDENCËS

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për dhënien e provimit të Jurisprudencës në afatin e Shtatorit 2022 dhe kanë kryer PAGESEN me datat 25-26 Tetor 2022, pjesa e Provimit të Jurisprudencës me shkrim do të mbahet me datat si në vijim:

Lënda: E Drejta Penale do të mbahet me datë 14 Janar 2023 (e Shtune) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.

Lënda: E Drejta Civile do të mbahet me datë 15 Janar 2023 (e Diele) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.

Kandidatët janë të obliguar që të paraqiten për regjistrim jo më vonë se ora 09:00.

Kandidatët të cilët nuk paraqiten në orarin e sipër cekur ose paraqiten pasi që të gjithë kandidatët hynë në sallën e mbajtjes së Provimit të Jurisprudencës, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim.

KANDIDATI ËSHTË I OBLIGUAR që të marrë me vete dokumentin personal për identifikim (letër njoftimin ose pasaportën). Nuk do të pranohet asnjë dokument tjetër.

KANDIDATIT I LEJOHET që në Provim të Jurisprudencës me shkrim, me vete të ketë vetëm: Legjislacionin përkatës në fuqi, lapsin kimik me ngjyrë të kaltër.

KANDIDATIT NUK I LEJOHET që të kenë në posedim: asnjë lloj telefoni, kompjuteri, kamere, dëgjuese-kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji.

KANDIDATIT NUK I LEJOHET që të kenë në posedim: asnjë lloj shënimi, materiali lexues apo material përshkrimi, forma të akteve gjyqësore dhe orë dore.

Shkelja e rregullave, nga ana e kandidatit rezulton me diskualifikimin e tij dhe shpalljen e provimit të pavlefshëm për të.

Po ashtu njoftohen të gjithë kandidatët se Provimi do të mbahet sipas Programit të ri, përkatësisht Udhëzimit Administrativ MD (NR). 06/2022 për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit

të Jurisprudencës, të cilin mund ta gjeni në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66522>

Vendi i mbajtjes se Provimit te Jurisprudencës me shkrim është **Akademia e Kosovës për Siguri Publike ne Vushtrri.**

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në web faqen e Ministrisë së Drejtësisë <http://www.md-ks.org>.